



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.05.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi për shqyrtimin nen për nen të Projekt Amendamenteve Kushtetuese, për dispozitën e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (neni 55) dhe dispozitat kalimtare dhe të fundit (nenet 57 – 58).

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Jorida Tabaku, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu.

Mungojnë:

Spartak Braho, Eduard Halimi

Të ftuar:

Rainer Deville - Shef i misionit të EURALIUS-it në Shqipëri
Jon Smibert - Përfaqësues i misionit të OPDAT-it në Shqipëri

Fatmir Xhafaj – Mirëdita! Mund ta fillojmë mbledhjen e komisionit, meqenëse realizohet kuorumi. Ju kërkoj ndjesë për vonesën, por ndodhi për shkak se disa prej kolegëve të komisionit janë edhe në mbledhjen që po zhvillohet me europarlamentarët në sallën tjetër.

Hapim seancën e debatit dhe të diskutimit. Para së gjithash dua të sqaroj se në rendin e ditës së sotme kemi shqyrtimin e nenit 55, që është neni për Këshillin e Emërimeve. Më pas janë dy nenet që lidhen me dispozitat kalimtare, që është neni 57 dhe neni 58. Duke qenë se janë tri nene, ka mundësi të ecim në shpejtë, në mënyrë që të marrim pjesë edhe në mbylljen e takimit të përbashkët BE-Shqipëri.

Fillojmë me nenin 55 “Këshilli i Emërimeve”.

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, kjo është një çështje e karakterit politik. Këtë e thotë edhe Komisioni i Venecias, në fakt edhe në krye të draftit thuhet se çështjet politike duhet të zgjidhen nga deputetët e këtij komisioni. Këshilli i Emërimeve është një tentativë për ta përmirësuar situatën mbi bazën e diskutimit politikë, ndërkohë që qëndrimi ynë ka qenë mjaft i qartë: Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është një organ i cili në rastin më të keq, ashtu siç ishte në draft, çonte drejt kapjes, dhe në rastin më të mirë i ka të gjitha elementet e korporatizmit. Ky është një organ i ri, të cilin e konsiderojmë të tepërt. Në propozimet që bëmë në lidhje me rikonceptimin e një skeme, që e keni dëgjuar gjatë propozimeve konkrete që kemi bërë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk do të kishte rol veçse për tre anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, por, të ngrihet një organ kolegjal vetëm për kaq, është e tepërt. Për të shkuar më thellë, edhe me propozimin e ri kemi të bëjmë me gjyqtarë që do të përzgjidhen me short, por për këtë do të them diçka pak më vonë. Gjyqtarët e përzgjedhur me short, me një afat vetëm 1-vjeçar, duke përfshirë edhe gjyqtarë që mund të vijnë nga shkalla e parë, do të duhet së pari të qëndrojnë në detyrë për një kohë të shkurtër dhe mund të jenë decizivët për të përcaktuar se kush do të jenë personat që do t'i disiplinojnë ata më pas në punën e tyre në KLGJ, eventualisht edhe në KLP. Pra, raporti korporatist, për fat të keq, mund të degjenerojë drejt klientelizmit, ma pas edhe drejt korrupsionit. Për më tepër, që një funksion vetëm 1-vjeçar nuk u jep asnjë lloj përgjegjshmërie këtyre gjyqtarëve apo prokurorëve të përzgjedhur për të shërbyer në këtë organ dhe për të çuar më pas në majat e sistemit të drejtësisë

gjyqtarët ose personat më kapacitetet më të larta profesionale dhe me integritetin më të lartë. Gjykimi i tyre do të ishte shumë i shkurtër dhe me interes shumë më të shkurtër, për rrjedhojë do të kishim të gjitha mundësitë për një pakt mosndëshkueshmërie. Kjo është ajo që të gjithë e dimë, pra korporatizmi ose pjesa më negative e tij.

Do të vijoj me mënyrën si është përzgjedhur. Është bërë tentativa për të shkuar drejt një sistemi që çon në një përzgjedhje të rastësishme, e cila në dukje nuk çon drejt një përcaktimi emrash që më parë. Ndërkohë, shorti aplikohet në një strukturë vertikale nga nivelet me të larta gjyqësore deri te niveli më i ulët. Sigurisht që shorti i verbër garanton, 50% e shansit, që të merret pjesa joelitare, qoftë e shkallës së parë apo edhe e apelit, të vijjnë në këtë organ të propozuar, që e komplikon skemën institucionale, figura me background jo të fortë profesional, le të themi, që nuk janë në maksimumin e integritetit etik. Këta persona do të vendosim se kush do të jetë në organet më të larta; kjo është edhe në rekomandimet më të hershme për Shqipërinë në raste të ngjashme. Unë kam cituar rastin e anëtarit të shtatë të KQZ-së, si organ kushtetues për t'u zgjedhur nga KLD-ja. Propozimi i asaj kohe sugjeronte shortin dhe ekspertët ndërkombëtarë të OSBE-ODIHR-it thanë në atë kohë se shorti do t'i kishte të gjitha mundësitë për të prodhuar jo kualitet, por të kundërtën dhe ishte një instrument jo i pëlqyeshëm në këtë aspekt.

Tani, të thëna këto, asgjë nuk hiqet nga shqetësimi i përgjithshëm i karakterit politik, që është komplikimi i sistemit me një institucion të tepërt, detyra e të cilit mund të kryhet shumë më mirë, për atë që mbetet për t'u bërë si punë, pra përzgjedhja e kandidatave dhe renditja si mekanizëm zhblllokues mund të bëhet shumë mirë nga organe të tjera. Ne kemi propozuar Gjykatën Kushtetuese. Kështu që ta mbajmë Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për një apo për dy organe do të ishte jashtëzakonisht e tepërt edhe për shqiptarët, sepse do të komplikonte dhe do të hapte mundësitë për kapje politike të procesit të emërimit të funksionarëve të lartë të drejtësisë. Kështu që ne jemi kundër krijimit të këtij organi, për rrjedhojë nuk kemi as propozim për një tekst alternativ. Është shumë i qartë, për arsye se kompetencat i transferojmë tek organe të tjera, siç është Gjykata Kushtetuese.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Dua të bëj një reagim lidhur me komentin që bëri kolegu Bylykbashi për nenin 55 ose për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. E konsideroj si pjesë të zgjidhjes politike dhe mendoj se është një abuzim i pastër më atë që ka thënë edhe Komisioni i Venecias, meqenëse jemi dakordësuar t'i qëndrojmë atij dokumenti bazë.

Së pari, në bindjen time, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është një organ shumë i nevojshëm. Është i domosdoshëm dhe i nevojshëm për dy qëllime kryesore në rastin konkret:

Së pari, për t'i shërbyer meritokracisë në përzgjedhje dhe për ta ndihmuar aspektin e vlerësimit të vlerave të kandidatëve.

Së dyti, për ta ndihmuar sa më shumë procesin e depolitizimit të përzgjedhjes së kandidaturave dhe ndikimit politik mbi procesin përzgjedhës. Me futjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi merr fund periudha e përzgjedhjes politike. Mbetet emërimi politik, por merr fund përzgjedhja politike. Ne sot kemi edhe përzgjedhje politike, edhe emërim politik. Me futjen e këtij organi, ky proces ndahet. Kjo do të thotë se përzgjedhja, që ka të bëjë me vlerat e kandidatit, me integritetin e tij nuk është më atribut i politikës, por është atribut i vetë sistemit. Kjo është një gjë shumë e madhe.

Së treti, është zhbllokimi në rastet kur krijohen ngërçe politike, që është një gjë tashmë e njohur në 25 vjet, ose më saktë nga Kushtetuta e vitit 1998 dhe deri më sot, të cilat kanë krijuar pastaj ngërçe institucionale në procesin e emërimeve. Pra, janë tri arsye të forta që e njohin ose që i japin vlerë qenies së këtij organi në strukturën e re të sistemit të drejtësisë. Mendoj se ekspertët duhen vlerësuar për këtë gjetje dhe për mënyrën e kujdesshme si e kanë parë këtë zgjidhje.

Ajo që dua të them së dyti është, edhe për kolegët, të cilët shpesh herë thonë “çfarë është kjo, po është shqiptare etj.), se nuk është shpikje shqiptare. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është një organ që e kanë shumë shtete, të cilave u ndërhyr politika në vendimmarrje, legjislatori. Meqenëse e kam përpara zotin Rainerin, atëherë po ju them që në Gjermani Këshilli i Emërimeve është një model shumë i konsoliduar, të cilin ne që jemi iniciatorë të atij projekti bashkë me disa prej kolegëve që janë këtu, kur vendosëm Këshillin e Emërimeve për procesin e emërimeve të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, u mbështetëm fort te modeli që ka sot Gjermania, që është një model shumë i konsoliduar. Pra, ka edhe një përvojë lidhur me të.

Çështja e tretë, që dua të diskutoj, është se nuk është një zgjidhje politike, meqenëse i qëndrojmë “Venecias”. Unë e kam fjalën për substancën për dy arsyt e mësipërme që përmenda, por, për të qenë edhe në kuadrin e asaj që diskutojmë. Kjo nuk është një çështje që është lënë hapur, të cilën mund ta diskutojë politika, sepse “Venecia” e ka mbyllur. “Venecia” jo vetëm që e ka mbështetur dhe e ka pranuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi (shpresoj që ata që kanë punuar nga krahu juaj ta kenë kuptuar këtë kur kanë lexuar “Venecian”), por e ka konsideruar të

pamjaftueshëm rolin e tij dhe ka shkuar përtej hartuesve të projektit. Nëse e lexoni me vëmendje raportin e Komisionit të Venecias, aty thuhet: “Jo vetëm në rastin kur i shqyrton Kuvendi kandidatët, por edhe kur i emëron Presidenti dhe kur i emërojnë tjerët duhet të hyjë Këshilli i Emërimeve”. Pra, Komisioni i Venecias e zgjeron rolin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të thotë se e ka pranuar organin, e ka mbyllur diskutimin dhe nuk ka lënë vend për diskutim politik për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi në ato organe që në arkitekturën e re të sistemit “Venecia” e konsideron jo thjesht një risi, por një zgjidhje fundamentale për të krijuar qëndrueshmëri të sistemit dhe për të ruajtur balancat ndërmjet pushteteve.

Po merrem edhe me detajin e fundit. Për sa i përket faktit që janë tre, e para, ne nuk e dimë sa do të jenë, sepse nuk e dimë formulën si do të votohen, pra më shumicë të cilësuar, pa shumicë të cilësuar, pra me një nga ato formulat e propozuara apo ku ta di unë se çfarë.

E dyta, e gjithë Gjykata Kushtetuese, sipas propozimit të “Venecias”, duhet të kalojë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Në qoftë se ju thoni se nuk jeni dakord edhe me “Venecian”, kjo është një gjë tjetër. E gjitha Gjykata Kushtetuese është e detyruar të kalojë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në procesin përzgjedhës. Ky është rekomandim i “Venecias”. Prandaj, të gjitha këto arsye janë më së të mjaftueshme jo thjesht për të justifikuar qenien e këtij organi në piramidën, në arkitekturën e re të sistemit, por edhe nevojën që kemi për ta konsoliduar dhe për ta forcuar atë. Çështja me gogla apo pa gogla, apo me short si e thotë zoti Bylykbashi, i cili nuk ishte dakord, rationale duket. Jam i bindur se për shkak të debatit tonë politik ekspertët kanë shkuar te kjo zgjidhje, edhe pse kanë pasur një ide të mëparshme. Gjithsesi, le të vendosim.

Rainer Deville – Mirëmëngjes! Ekzistenca e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është një çështje thjesht teknike. Ajo është e bazuar në Komisionin e Venecias, i cili ka kërkuar një grup ekspertësh për këtë detyrë. Pra, krijimi i këtij institucioni bazohet në Komisionin e Venecias, është aprovuar nga ky i fundit, dhe ekzistenca e tij është vlerësuar shumë nga Komisioni i Venecias qysh nga fillimi, pas një serie pyetjesh të ngritura përfaqësuesve të Venecias. Në draft opinionin përfundimtar është e qartë përsëri në pikën 11 që ky është një institucion i nevojshëm, kështu që është brenda standardeve të Komisionit të Venecias. Megjithatë, lidhur me pyetjen se si duhet të përbëhet ky Këshill, këtu ne kemi pasur disa diskutime. Siç e shihni në versionin aktual neni është blu, që do të thotë që ne u përpoqëm të merrnim në konsideratë shqetësimet e opozitës dhe ishte ideja e opozitës për të zëvendësuar zgjidhjen shkencore me elementin e llotarisë. Z. Bylykbashi ka kërkuar të ketë një background

të fortë profesional të anëtarëve - ky është versioni origjinal që ne kemi pasur - kështu që kthehemi te version origjinal që ju nuk e doni, ajo që ne u përpoqëm të bënim ishte të lehtësonim kompromisin duke marrë këto dy propozime. Në qoftë se kjo zgjidhje që propozoni së fundmi nuk është më në vizionin tuaj politik, atëherë ju duhet të ktheheni te version shkencor. Ky është një institucion i nevojshëm dhe nuk është korporativizëm, ai përbën një ndarje të pushtetit, është i përbërë nga ekspertë dhe rotacioni shërben si një mjet që lufton korrupsionin. Mund ta bëjmë më të qartë tani: Përfshirja e Këshillave në procesin e emërimit përfaqëson një mbrojtje për të përjashtuar emërimin e pastër politik, edhe në situatën ku mazhoranca kontrollon 3/5 e votave të parlamentit. Ky model i propozuar në projekt është i pranueshëm. Ky është Komisioni i Venecias dhe mendoj se nuk ka asnjë dyshim për këtë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Rainer!

Fjalën e ka kërkuar zoti Majko.

Pandeli Majko – Do të bëja propozime për sa i përket nenit, por bashkohem me atë që sapo tha zoti Oerd që kjo është një çështje politike, por nuk është një çështje politike ndërmjet mazhorancës dhe opozitës, por është një çështje politike e cila vë në dyshim të gjithë diskutimin e deritanishëm të reformës dhe pozicionin e vetë Partisë Demokratike. Po e vazhdoj aty ku e la eksperti fjalën, pra tani pozicioni i Partisë Demokratike ka përballë pozicionin e mëparshëm të Partisë Demokratike për komisionin e emërimeve. Meqenëse diskutimi u bë në parim, dëshiroj të them se Këshilli i Emërimeve mbetet pika më e fortë e kësaj reforme për ankimin e gjyqtarëve. Për t'ua kujtuar kolegëve, po citoj paragrafët e opinionit të e “Venecias”, 16, 20, 24, 38, 40, 82. Nuk besoj se ka pasur për ndonjë institucion tjetër kaq shumë paragrafë të shprehur nga Komisioni i Venecias sa për Këshillin e Emërimeve. Nga pikëpamja institucionale e arkitekturës, për të cilin ne, të dyja palët, kemi rënë dakord, të paktën, në qoftë se jam korrekt me dokumentin e datës 9 maj 2016 lënda “Konsiderata të përgjithshme mbi amendamentet kushtetuese”, që i është drejtuar komisionit të posaçëm parlamentar për realizimin e reformës, që është për dijeni të zotit ambasador të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Lu dhe të zonjës Romana Vlahutin, nga këto që dëgjova sot nga përfaqësuesi i ri, i sapozgjedhur nënkryetar i komisionit parlamentar, nuk pashë ndonjë opinion. Prandaj, mendoj se kjo mbetet një çështje politike, e cila nuk mendoj se duhet ta kthejë në një pikë të vdekur të gjithë diskutimin e asaj që kemi bërë deri tani.

Për sa i përket nenit, jam dakord që pika 1 e nenit 55 të jetë kështu siç është formuluar, por me një ndryshim, propozoj të hiqet fjalia e fundit, pasi mendoj se mund të ngjallë keqkuptime apo keqinterpretime të natyrave të ndryshme. Për sa i përket pikës 3, unë do të propozoja që këshilli i emërimeve të ketë një riformulim të plotë: “Këshilli i Emërimeve në Drejtësi përbëhet nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese, kryetari i Gjykatës së Lartë, kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative, kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prokurori i Përgjithshëm, kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, gjyqtari më i vjetër i Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtari më i vjetër në detyrë i Gjykatës së Lartë”.

Mendoj se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka qenë menduar si një organ *ad hoc*, anëtarët e të cilit caktohen *ex officio* me përbërje të ndryshme dhe që janë garantues të standardeve, kriterëve profesionale, morale të kandidatëve të organeve kushtetuese.

Me të drejtë këtu është përmendur shpesh çështja e korporatizmit. Pse mendohet që anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, që punojnë së bashku, gjykojnë së bashku, nuk bëjnë korporatë në sensin e një subjektivizmi negativ maksimal dhe përfaqësuesit e institucioneve, që vijnë nga drejtime të ndryshme, siç është e gjithë elita e sistemit të drejtësisë, siç e citova edhe në propozimin tim kanë rrezikshmëri, pra, na bëjnë korporatë?

Unë mendoj se ne vazhdojmë të ndahemi thellësisht në mënyrën e kontrollit të politikës për sa u përket emërimeve në sistemin e drejtësisë. Nëse doni një shembull të koorporatizmit, të nderuar kolegë, koorporatizmi më i pastër sot është Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i cili me subjektivizmin dhe kulturën politike që ne kemi prodhuar në kaq vite, pavarësisht se ai si sistem mbetet funksional dhe ka shembuj të tjerë në Perëndim, ka prodhuar monstra në kuptimin e vërtetë të fjalës. Nuk besoj se jam duke thënë ndonjë legjendë urbane, por ka arritur deri aty sa gjykatës, të cilët në Institucionin e Lartë të Deklarimit të Pasurive nuk kanë deklaruar deri edhe vila, pastaj kanë dalë pa pikë turpi, dhe kjo dua që të jetë pjesë e rekordit të këtij diskutimi, dhe janë justifikuar për vila të padeklaruara në bregdet.

A e dini se cili ka qenë justifikimi i gjyqtarit që akuzohej nga ILKDP-ja përballë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që drejtohet nga Presidenti i Republikës? Arsyetimi i tij dhe që është justifikuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ishte se atë vilë e kishte për një lidhje jashtëmartesore dhe sot ky gjyqtar vazhdon punën i qetë si gjykatës. Kjo është një histori dhe jo legjendë urbane, që ka ndodhur në Këshillin tonë të Lartë të Drejtësisë.

Ndaj, ju lutem, kur flisni për korporatizmin, kini parasysh se po flasim për të rindërtuar një sistem i cili do të shmangë pikërisht këtë dramë që ndodh brenda sistemit tonë të drejtësisë të gatuar dhe të justifikuar edhe nga duart e politikës.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Majko!

Zoti Bylykbashi, urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – I nderuar kolegu Majko, besoj se është e domosdoshme që ne ta rishikojmë dhe ta rikonceptojmë sistemin e sotëm, që është një sistem europian, por që e kemi me probleme, sepse, me sa duket, i kemi futur ngarkesën problematike që i fusim gjithmonë sistemit dhe ai prishet.

KLD-ja korporatiste?! Po, mund ta jap. 15 anëtarë, 2/3-at janë gjyqtarë. Që të përmbysset një vendimmarrje, që duhet të jetë e thjeshtë me shumicë absolute, është pamundur eventualisht dhe për këtë besoj se kemi rënë dakord.

Raporti do të jetë 6 me 5, por jo vetëm kaq, por për të garantuar që 5-shja nuk bëhet 6 në favor të qeverisë, 5-shja nuk zgjidhet me formulën që propozoni ju, por me formulën që propozojmë ne.

Për rrjedhojë, qeverisë do t'i duhet të bëjë 3 të vetët dhe 3 gjyqtarë, t'ua mbushë mendjen gjyqtarëve dhe të vendosë edhe kundërgjyqtarë. Nuk ka asnjë lloj problemi, por nuk mund ta kapim politikisht. Pra, së bashku kemi rritur ndërhyrjen publike mbi korporatën, që këta të mos livadhisin, siç kanë bërë deri më sot dhe të mos dëgjojmë jo vetëm ato histori, por që KLD-ja të mbrojë edhe gjyqtarë të lidhur me krimin e organizuar. Nuk po përmend emra, se e dimë shumë mirë se çfarë lufte është bërë dhe ju e keni mbajtur. Në këtë çështje mendjen duhet ta kemi të pastër nga të gjitha ato që mendojmë se i kemi argumente në favor apo kundër njëritjetrit.

Me gjithë respektin e komentit të ekspertit, zotit Devil, mbetet përsëri çështja që thotë Komisioni i Venecias se oportuniteti në lidhje me vendimmarrjen politike mbi sistemin mbetet me legjislatorin shqiptar dhe asgjë, deri më sot, nuk ka ndodhur që të zhbëhet ajo që u tha, e zezë mbi të bardhë, që sistemi është shumë kompleks, shumë i rëndë e, për rrjedhojë, do të arrijë në vendimmarrje të komplikuar, të cilat mund të përkeqësojnë akoma më keq perceptimin e sistemit të drejtësisë.

Kjo nuk është histori se si do të ndajnë pushtetin brenda për brenda sistemit të drejtësisë, por ky sistem kaq i ngatërruar, që propozoni ju, do t'i japë perceptimin gjyqtarit të

Shkallës së Parë që, meqë nuk merren vesh atje sipër pse duhet ta vrasë mendjen unë dhe të japë drejtësi këtu poshtë. Mbaroj edhe unë punët e mia.

Sistemi që propozoni është jo thjesht i komplikuar, por është i ngatërruar. Ngatërrohet me këmbët e tij dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, është guri i qemerit i kësaj ngatërrese që propozoni ju. Ne themi, të njëjtën gjë e bën edhe dikush tjetër. Po, me të njëjtat kualitete, me të cilat...

(Mungesë incizimi.)

Le të bëjmë një analizë të thjeshtë. Për çfarë propozohet Këshilli i Emërimit në Drejtësi? Për anëtarët jogjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, 5 veta; kandidatët jo prokurorë për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, 5 veta; kandidatët për Inspektorë të Lartë të Drejtësisë, 3 veta, në mos gaboj, dhe kandidatë për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese që emërohen nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi, 6 veta.

Madje thuhet që renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme dhe ky është rregulli bazë, me përjashtim të rastit kur Kuvendi nuk arrin të emërojë kandidatin dhe ne mund të gjejmë një formulë që të garantojë suksesin dhe konsensusin në përzgjedhjen e kandidaturave për 5 anëtarët e KLGJ-së, 5 anëtarët e KLP-së, për Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë dhe për 3 anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, sepse Presidenti është monokratik. Me dekret ai nuk pyet se cila është renditja midis profesionistëve të përzgjedhur. Në një mënyrë ose një tjetër përzgjedh ai.

Ne propozojmë 5 anëtarët e KLGJ-së, siç na kanë propozuar partnerët ndërkombëtarë dhe Komisioni i Venecias, formula e vendeve të rezervuara. Kjo e zgjidh problemin. 5 pozicionet e KLP-së në të njëjtën formë me vende të rezervuara. E zgjidh problemin. Mbetet ILD-ja dhe 3 anëtarët e kushtetueses që zgjedh parlamenti për 4 pozicione gjithsej...

Zoti Majko, unë besoj se qetësia do të na çojë në zgjidhje jo në nervozizëm. Për kaq pak po ju garantoj që Gjykata Kushtetuese është perfekt e aftë në atë që të gjithë e njohin si *peer review*, të bëjë një vlerësim të 3 personave që duhet të vijnë si anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Për çfarë? Se sa profesionistë janë, sa i përputhin kushtet që i kërkon ligji dhe vlerësimin etik? Po çfarë po themi? Për kaq?! Atëherë i'a transferojmë dikujt tjetër. Kështu që ky ushtrim shkencor zgjidhet me të njëjtën mënyrë shkencore.

Po e bëj të qartë: KED-ja është pjesë integrale, e padiskutueshme, madje, pjesë kryesore e diskutimit mbi sistemin dhe ne themi sistemi do të thjeshtohet, sistemi kaq i vështirë nuk

mbetet. Nëse i bie KED-së të ikë e para, duhet të gjejmë një gjë po aq shkencore, ndoshta edhe më shkencore. Kjo nuk është çështje teknike. Duhet të vijmë deri aty dhe pastaj e zgjidhim.

Zoti Majko, ju garantoj se pozicioni që ne paraqesim këtu, qofsha unë në funksionin më të ri në këtë histori, nuk është asgjë, as e imja, as e kolegut Ristani dhe as e kolegut Strazimiri. Është një pozicion i qartë kushtetues, juridik, profesional, politik, i cili është bërë prezent në publik dhe në grupin parlamentar të Partisë Demokratike, siç jeni ju të bindur dhe Kryeministri del e thotë e votojmë edhe pa e lexuar fare draftin që kemi bërë vetë.

Meqë jemi në këto pozicione, merre të mirëqenë këtë, sepse është proces dhe procesi njeh edhe evolucionin. Të jeni të sigurt nuk është pikë zero. Është fillimi i fazës së re, zoti Majko.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Strazimiri, urdhëroni!

Gent Strazimiri – Kujt po ia lëmë kompetencat e Këshillit të Emërimeve?

Gjykatës Kushtetuese, e cila është një trupë e krijuar për të bërë një detyrë shumë herë më të madhe se Këshilli i Emërimeve? Nuk është politike. Është një trupë që krijon norma. Përfaqësuesit e sovranit shkojnë dhe e pyesin se çfarë duhet të bëjnë me këtë punë dhe nuk diskutohet më, bëhet.

Besoj se është detyrë shumë herë më e rëndësishme se sa të bëjë edhe përzgjedhjen e profesionalizmit mbi bazën e profesionalizmit dhe jo të përkatësisë politike të gjyqtarëve.

Për rastet që përmendni në KLD, unë nuk e di, por ju besoj (mbledhjet e KLD-së përgjithësisht janë të mbyllura, ju i merrni informacionet nga brenda), mund të ketë ndodhur edhe ky rast që thoni ju, zoti Majko.

Fatmir Xhafaj – Më fal, për saktësi. Ndoshta për shkak të atij ligji për KLD-në që e ndryshuam ne dhe e kundërshtuat ju, procesverbalet janë në faqen zyrtare.

Gent Strazimiri – Edhe këtë që thotë zoti Majko?

Fatmir Xhafaj – Të gjitha.

Gent Strazimiri – Kjo është gjë e madhe. Shumë mirë. KLD-ja është një pjellë unilaterale jo në bashkëpunim me ne. Këtë KLD që kemi, kaq të nxirë, me këtë përbërje etj., etj me radhë, nuk e kemi bërë ne. E keni bërë vetë ligjin mbi KLD-në, si çdo ligj me 2/3-at, në periudhën e ndritur '98-2005. Nëse gënjej më thoni, shohim edhe procesverbalet.

E keni dashur krejtësisht jo politike aq sa kemi bërë sherr me zonjën Hysi në Komisionin e Ligjeve. A quhet njeri politik një person, që ka qenë zëvendësministër në një qeveri socialiste apo demokratike?

Meqë kandidati nuk duhej të ishte politik, u konsiderua që një zëvendësministër nuk është person politik. Sot ai është anëtar i KLD-së. Nuk e çuan dot në Gjykatën Kushtetuese, as në Gjykatë të Lartë, por sapo erdhi, e futën në KLD. Nuk po përmend emra, se e dini vetë. Kështu që edhe tek influencat politike në KLD përsëri nuk na e vini dot fajin neve. Është kjo KLD-ja e nxirë, që na e përshkroi zoti Majko. Dakord, hajde ta ndërrojmë! Të ndërrojmë modelin.

Unë nuk mendoj se ka një draft kushtetues, opinion të Venecias apo opinion teknikësh që mund t'ju ndalojë ju apo eventualisht ne, të propozojmë atje apo të luftojmë me njëri-tjetrin për persona që kemi vendosur të mos i quajmë politikë megjithëse kanë qenë anëtar kabineti. Këtë nuk e zgjidh dot asnjë rregull.

Cili quhet person politik dhe cili nuk quhet, ne e shohim në mënyra të ndryshme.

Aktualisht, me formulën që ne propozojmë kam përshtypjen që nuk duam të gllabërojmë drejtësinë. Nuk ka asnjë mundësi teorike, siç nuk kemi pasur kurrë edhe gjatë periudhës 2005- 2013. Maxhoranca jonë ka qenë e detyruar të votojë çdo kandidaturë që sillte Presidenti i Republikës. Nga viti 2005 deri në vitin 2013, maxhoranca e drejtuar nga Partia Demokratike nuk ka pasur absolutisht asnjë influencë të Presidentit i Republikës. Përkundrazi, ka pasur konflikt të hapur dhe ky është fakt i njohur publik.

Kështu që edhe këtë nuk na e lini dot neve. Çfarë janë sot? Cilët janë kandiduar? Kur kemi qenë ne në qeveri, kanë qenë persona që nuk kanë qenë të përzgjedhur dhe nuk mund t'i përzgjidhim dot ne. Kanë qenë kandidatura të Presidentit të Republikës.

(I drejtohet zotit Xhafaj.) Në qoftë se ne do të mbërrijmë në pikën që ju nga moderator do të ktheheni edhe në sugjerues të atyre që unë them, unë fare mirë mund t'ju them që në emrin tim do të flasë zoti Xhafaj dhe po iki që këtu. Më lini të mbaroj argumentin!

Do të zgjidhet kjo Gjykatë Kushtetuese me ato rregulla që vendosëm të gjithë bashkë dhe do ta ketë mandatin 9 vjet. Në 9 vjet ju do të zgjidhni një trupë që do të zgjasë 9 vjet. Se sa mundësi kemi ne sot në këtë moment ta gllabërojmë me persona politikë nga ata që vetëm ne zgjedhim, se ju kurrë, (ju keni 26 vjet që zgjidhni me maxhoranca me 2/-3at gjyqtarët dhe kurrë nuk janë politikë, gjithmonë jua gllabëron politika), sot jemi të bindur që më shumë se kaq nuk keni ku shkoni. Opozita e ka zero mundësinë e ndikimit. Në 9 vjetët që vijnë nga dita që do t'i

zgjidhni, nuk besoj se nuk ua keni besën, pasi i zgjidhni për të na ndriçuar me jurisprudencë. Kështu që edhe nga kjo pikëpamje jemi të mbrojtur, nuk j'ua gllabëron dot opozita.

Ta kthesh këtë pastaj në një kalë beteje me argumentet se po jua merr opozita, edhe kjo nuk ju shkon. Mendoj se duhet të ulemi dhe ta shohim me sinqeritet dhe me këmbë në tokë, në qoftë se duam të bëjnë diçka. Në qoftë se nuk doni reformën, është punë tjetër. Mund të përdorni votën dyfishe, por kjo nuk është arsye për t'u bërë kalë beteje, veçanërisht në këtë tryezë, veçanërisht në këtë pikë në të cilën jemi.

Ejani të gjejmë një mundësi! Mos u trembni nga një opozitë, që nuk ka as 1/3 - ën. Ejani të vendosim disa rregulla!

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Zonja Hysi, keni fjalën.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Në radhë të parë, dua të falënderoj ekspertët për opsionin e mundshëm që na kanë paraqitur, në përgjigje të komenteve të ngritura nga opozita më 27 prill të vitit 2016.

Personalisht, pavarësisht vlerësimit për punën e ekspertëve, jam për variantin e parë të paraqitur në dokument dhe dua të jap argumentet e mia pse jam dakord.

Së pari, mbështes idenë ose tekstin që i dërguam Komisionit të Venecias për të pasur një Këshill të Emërimeve në Drejtësi, që të jetë shkencor-akademik. Për këtë dua të jap disa argumente pse.

Në radhë të parë, këta persona, që janë iniciuar për të qenë pjesë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, pra në draftin që i kemi çuar Komisionit të Venecias, mendohet se do të jenë njerëzit më të mirë të përzgjedhur ndërmjet të gjithë trupës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë dhe jo nga politika.

Së dyti, kjo krijon një stabilitet dhe një unifikim të praktikave të emërimeve të kandidatëve jogjyqtarë dhe joprokurorë, por në institucione shumë të rëndësishme. Varianti i sjellë, si një opsion i mundshëm për të kënaqur pretendimet opozitës, sidomos për periudhën e tranzicionit, ka futur disa elemente, që e bëjnë delikat këtë Këshill të Emërimeve në Drejtësi.

Së treti, do të kemi një Këshill të Emërimeve në Drejtësi për një funksion njëvjeçar. Pra, çdo vit do të ketë një rinovim dhe pa dyshim do të ketë debate dhe diskutime ndërmjet

institucioneve të ndryshme, sidomos me Presidentin, nëse Presidenti nuk ushtron funksionet, Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë.

Së dyti, është futur mekanizmi i shortit, i cili në pamje të parë duket më i miri i rastësishëm, por në përvojat që ne kemi pasur në Shqipëri, shqiptarët i'a kanë gjetur mënyrën edhe shortit. Mjafton të sjellë rastin e ndarjeve për kthimin dhe kompensimin e pronave, ku personit, i cilit duhet të merrte i pari një pronë në mes të Tiranës, i'u mbajtën goglat 24 orë në frigorifer që të ishin të ftohta dhe u tërhoq pikërisht ajo gogël që duhej nga personi i duhur. Ja pra që gjendet mekanizmi i shortit.

Nga ana tjetër, duke zbritur te niveli më i ulët i gjyqtarëve dhe i prokurorëve, mendoj se jo të gjithë do të kenë atë nivel që ka kryetari i Gjykatës Kushtetuese, kryetari i Gjykatës së Lartë apo kryetar i Gjykatës Administrative.

Argumenti i tretë, që kolegët këtu nuk e thanë, është se ne i kemi lënë shumë kompetenca Gjykatës Kushtetuese. Nëse i referohemi nenit 147/f, që kemi kaluar ankimimet kundër vendimeve të Tribunalit Disiplinor të Drejtësisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë ia kemi lënë Gjykatës Kushtetuese. Ndërkohë, i bie që anëtarët e Gjykatës Kushtetuese të diskutojnë për kandidatët për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese e të tjerë. Pra, është koklavitur shumë në këtë kuadër.

Varianti i parë i bërë nga ekspertët dhe ekspertët e huaj jo vetëm që është më i mirë, më i shkurtër, më i qartë dhe më i saktë nga ana e teknikës legjislative, por ruan edhe standardin profesional dhe shkencor.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Keni edhe ju diçka? A ta mbyllim me zotin Ristani?

Në rregull!

Arben Ristani - Unë mendoj se çështjet që po diskutojmë janë realisht të një rëndësie të veçantë. Retorikat politike dhe shembujt me gogla, për mua ia humbin rëndësinë këtij diskutimi që po bëjmë. Po të futem edhe unë në këto çështje nuk është e arsyeshme, kështu që le t'i marrim gjërat thjesht dhe të kuptohemi me njëri-tjetrin.

Sigurisht që drejtësia në Shqipëri ka probleme dhe sigurisht që kemi nevojë ta riformojmë patjetër, por ta etiketojmë si delen e zezë të kësaj shoqërie nuk jam dakord, sepse korrupsion ka sa të duash qeveria, zërat e qeverisë e të tjerë. Drejtësia nuk është delja e zezë, por është një sektor që vuan nga korrupsioni dhe duhet riformuar patjetër.

Unë besoj se një sistem i thjeshtë i mirëmanovruar është një zgjidhje më e mirë, se një sistem i komplikuar. Tani jemi duke ballafaquar variantet. Jemi në politikë, ju keni një variant, ne kemi një variant, le t'i shohim si koordinojnë, në mënyrë që të bëjmë një gjë të mirë.

Sistemin e KLD-së e kemi pasur me 15 anëtarë. Kishim 9 gjyqtarë, 10 gjyqtarë, me gjithë kryetarin e Gjykatës së Lartë, 3 të zgjedhur nga parlamenti që bëjnë 13 dhe bashkë me Presidentin dhe ministrin bëjnë 15. Po ta shikoni kompozimin, kemi 10 gjyqtarë dhe 5 anëtarë nga politika. Atë që ne po e quajmë sot "korporatizmi" ishte mëse evident. Ne po pranojmë së bashku një variant për të mos i lënë shumë vend gjyqësorit, por ta zvogëlojmë raportin dhe ta anojmë nga politika, sepse mendojmë se ky është një balancim ndërmjet pushteteve. Kjo është logjika që të shkojmë te varianti 6 me 5.

Fatmir Xhafaj - Ka edhe prurje nga jashtë sistemit.

Arben Ristani - Gjithsesi, janë të zgjedhur nga politika, të zgjedhur nga një shtyllë tjetër e pushtetit për efekt të balancës. Pra, kishim 10 me 5, po e bëjmë 6 me 5. Dakord?

Është një variant, ku kërkohet të ketë një këshill emërimesh, i cili do të rendisë 5 anëtarë të KLP-ja, 5 anëtarë të KLGJ-ja, ILD-ja, dhe 3 anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Për të bërë këtë gjë po krijojmë një këshill emërimesh dhe po t'i qëndrojmë këtij varianti duhet ta kemi një këshill emërimesh.

Ne kemi një propozim tjetër: duke qenë se nuk besojmë te balanca që është sot në parlament, te votat me 3/5-at, sepse ju keni shumicën, mendojmë se në Shqipëri politika nuk është aq e përgjegjshme sa t'i lërë të lira këto organe, por i kap. Ky është një problem që ne e dimë dhe nuk kemi pse të fshihemi pas gishtit. Unë nuk kam fare besim se me 3/5-at që zotëron sot PS-ja në parlament nuk e bën zgjedhjen në mënyrë të atillë që të emërojë njerëzit e saj. Kjo është një gjë që ne e kemi me njëri-tjetrin. Nga të gjitha historitë që kemi pasur, kemi arritur në përfundimin që nuk kemi më besim.

Atëherë, ne propozojmë një sistem më të thjeshtë dhe themi: kemi 5 anëtarë që do t'i zgjedhë politika në KLP? Po. Atëherë, 2 le t'i propozojë maxhoranca nga e njëjta pishinë e njerëzve, nga avokatët, nga noterët, nga pedagogët, se nuk do t'i sjellim nga Kina propozimet tona. Pra, nga e njëjta pishinë ju do të propozoni 2, ne do të propozojmë 2, kurse 1 le ta propozojë një mekanizëm tjetër, siç është shoqëria civile.

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, duke i zgjedhur në këtë formë bie roli i KE-së te KLP-ja dhe te KLGJ-ja. Na ngelen vetëm 3 propozime të Presidentit, se Presidenti është monokratik, nuk ka dyshim që kur ato renditen ai zgjedh, sepse nuk ka nevojë që t'i rikthehesh, ngelen për t'u zgjedhur 3 anëtarë të Gjykatës Kushtetues edhe 1 nga ILD-ja.

Në këto kushte ne mendojmë se Gjykata Kushtetuese, duke qenë se është një organi më i lartë i hierarkisë të organeve shtetërore, me njerëzit më të përzgjedhur, e ka më të thjeshtë që vetë ajo të bëjë edhe renditjen e 3 gjyqtarëve edhe renditjen e kandidaturave për ILD-në.

Në këto kushte bie logjika e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi që ne po përdorim. Unë besoj se ne jemi korrekt me mënyrën se si e koncentrojmë sistemin, pastaj a biem apo jo dakord, kjo është tjetër gjë. Unë besoj se kemi një logjikë për mënyrën se si po e bëjmë propozimin dhe në mënyrën se si po ngremë arsyetimin tonë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ramë dakord se do ta mbyllim këtu këtë diskutim. Besoj se ishte i qartë edhe pozicioni i ekspertëve ndërkombëtarë, që u parashtrua këtu në mbështetje të variantit që ishte, por edhe rezervat që shfaqën kolegët e PD-së lidhur me këtë zgjidhje të ofruar.

Oerd Bylykbashi - Le ta bëjmë të qartë, nuk është rezervë. Ky nen në propozimin tonë nuk është fare.

Fatmir Xhafaj - Në rregull!

Atëherë, i bie që ta votojmë vetëm ne.

A keni koment?

Po, zoti Smibert.

Jon Smibert – Unë në fakt dua vetëm të bëj një ndërhyrje. Cilindo vendim të merrni, si një ekspert ndërkombëtar që unë jam këtu në Shqipëri, do të nxjerr në dukje disa nga normat ndërkombëtare. Kur ne flasim për Gjykatën Kushtetuese, sipas vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ajo konsiderohet e pavarur dhe e paanshme. Ka praktikë gjyqësore e cila flet për paanshmërinë e një trupi si Gjykata Kushtetuese ose të çfarëdo organi tjetër që ka funksione të shumta. Duhet të ketë një lexim të fortë të këtyre lloj rasteve të praktikës gjyqësore të GJEDNj-së, kur jeni duke u përpjekur të vendosni funksione të shumta në një trup si Gjykata Kushtetuese. Unë do isha i lumtur për të folur për këtë pjesë me këdo më pas, por unë mendoj se duhet vërtetë të bëhet kujdes. Duke pasur një Gjykatë Kushtetuese që bën

rekomandime në lidhje me njerëzit, kur këta të fundit më vonë kanë për të gjykuar procesin e emërimit ose procesin e rekomandimeve që kanë bërë vetë, etj. mendoj se shkrirja e këtyre lloj gjërave implikon një jurisprudencë e cila do konsultuar me kujdes.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

E mbyllim këtu këtë diskutim dhe besoj se të gjithë jemi të qartë me atë çfarë mendojmë.

Vazhdojmë me nenet 57 dhe 58 “Dispozitat kalimtare”.

Para se të fillojmë diskutimet, dua të them se po të m’i jepnit detyrë shtëpie këto dy nene, unë nuk do t’i shkruaja dot personalisht, ndoshta sepse janë shumë të koklavitur. Unë e kuptoj shumë mirë sa të vështirë e kanë pasur ekspertët ndërkombëtarë që të arrijnë të përputhin nevojën për të rregulluar shumë zgjidhje me këto dispozita kalimtare.

Dua t’u them edhe kolegëve që të jenë të kujdesshëm, sepse nuk është një gjë e lehtë, plus që çfarëdolloj gjëje që të bëjmë ne tani, zgjidhjet që do të japim edhe në vazhdim kur ta përfundojmë, përsëri do të kenë nevojë për t’u futur te dispozitat kalimtare. Nëse do të ketë sugjerime, le të jenë sugjerime përmirësuese, pa hyrë në debate. Pra, le të rrimë te niveli teknik, sepse edhe këto janë mirëfilli teknike. Më pas do të kondicionohen shumë nga zgjidhjet finale që do të japim nga njëra anë, dhe, së dyti, nuk është e lehtë që të përputhesh edhe nenin përkatës, sepse nga shpejtësia mund të bësh gabime dhe është e mirëkuptueshme.

Po e përsëris edhe një herë: i përgëzoj ekspertët që me kaq pak gabime, sipas meje ku mund të ndërhyhet, kanë arritur të bëjnë një punë të mrekullueshme, sepse nuk është e lehtë. Kështu që duhet mirëkuptim dhe nga pikëpamja teknike duhet të jemi të kujdesshëm, sepse duhet ta kemi të gjithë kuadrin të qartë, në mënyrë që të ndërhyjmë te Dispozitat Kalimtare.

Besoj se ishte një lutje shumë shoqërore me kolegët, në mënyrë që të mos e ngarkojmë këtë pjesë, të paktën këto dy dispozita, me diskutime politike. Të zhvishemi te këto dy dispozita nga diskutimet politike dhe të flasim thjesht për gjëra teknike, për shkak se këto lidhen me zgjidhjet e përgjithshme që do të bëjmë. Besoj se biem dakord, apo jo? Në rregull!

Faleminderit!

Kush ka ndërhyrje teknike për këto dy dispozita.

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi - Në sistemin që ne propozojmë dhe në sistemin që ju propozoni ka një element thelbësor, i cili, sigurisht, mbështetet edhe nga raporti i Komisionit të Venecias, që është ruajtja e mandateve ekzistuese.

Përveç traditës ku madje edhe ju keni thënë herë pas here që është e rëndësishme ruajtja e mandatit e të tjerë dhe më pas keni thënë se duhet ta ndërpresim mandatin këtu e të tjerë, një nga gjërat më të dëmshme që i bëhet stabilitetit institucional të këtij vendi është mosruajtja e mandatit. Nuk po hyj fare te pjesa që ne akuzojmë se rotacioni politik i vitit 2013 çoi në ndërprerje mandatesh nëpërmjet votave të shumicës. Kjo do të ishte edhe më e papranueshme në qoftë se ne këtë gjurmë të zezë e lëmë sot në Kushtetutë. Pra, ne jemi për ruajtjen e funksioneve deri në mbarimin e tyre, të atyre që janë në funksione kushtetuese dhe kjo dispozitë duhet ta reflektojë këtë.

Nga Komisioni i Venecias është thënë se prokurori Përgjithshëm duhet të vazhdojë të jetë në detyrë; Presidenti i Republikës duhet të vazhdojë në funksionet e tij deri në një moment të caktuar. Ne kemi anëtarë të KLD-së që do të bëhet KLGJ nesër, të cilët sapo janë zgjedhur e kështu me radhë.

Stabiliteti është një nga gjërat më të rëndësishme. Ruajtja dhe pavarësia, madje një nga themelet e pavarësisë së institucioneve, ku si parim është kur ruajmë qëndrimin në detyrë, dhe ruajtja e mandatit ka të bëjë më qëndrimin në detyrë, garancinë e qëndrimit në detyrë, mosndërprerjen e atij mandati nëpërmjet ndryshimeve ligjore dhe e gjithë kjo është e lidhur me pavarësinë.

Nuk besoj se ka njeri që mund ta thotë publikisht: “Qeveria do që ta kapë pavarësinë”. Ju këtë nuk e thoni dot, por e gjitha del nga kjo.

I gjithë ky ndryshim thelbësor që i bëhet sistemit duke e copëtuar, e fragmentuar në copa, ku copës mund t’i gjendet një model diku, por sistemit nuk mund t’i gjendet model askund, është pjesë e asaj që ne e kemi konsideruar si kapje dhe çimentim i kapjes politike për një periudhë të gjatë. Kështu që në këtë aspekt ruajtja e mandateve ekzistuese të funksionarëve kushtetues në sistemin e drejtësisë është e rëndësishme.

Dispozita e propozuar nuk e bën këtë, por shkon në të kundërtën e kësaj. Ky është pozicion shumë i qartë që kemi ne, është i reflektuar edhe në draftin që kemi ne, por kur të vijë momenti të hyjmë konkretisht do të japim propozimet tona.

Fatmir Xhafaj - Ju lutem, që të qëndrojmë pak më të fokusuar! Për cilat mandate e keni fjalën se nuk po e kuptoj?

Oerd Bylykbashi - I përmenda, zoti kryetar!

Pra, Prokurori i Përgjithshëm qëndron në detyrë sepse e ka thënë Komisioni i Venecias që nuk ka arsye pse.

Në momentin kur KLG-ja hyn në fuqi është kur Presidenti i Republikës mbaron këtë funksion që ka. Ju keni anëtarë të KLGJ-së sot, të cilët sapo janë zgjedhur dhe në mos gaboj duhet të jetë një numër i caktuar dhe nuk ka asnjë motiv dhe asnjë arsye, pse të mos i ribëjmë tani me shumicën tonë, pra ta nisim sistemin me shumicën tonë dhe më pas të kapim këtë pjesë, kjo gjithashtu nuk ka të bëjë me pavarësinë e sistemit.

Fatmir Xhafaj - Pra, fjala është, ashtu si e kuptoj, unë për Presidentin e Republikës.

Oerd Bylykbashi - Jo, është për të gjithë spektrin e funksioneve kushtetuese.

Fatmir Xhafaj - Pra, të qëndrojnë Këshilli i Lartë i Drejtësisë siç është?

Oerd Bylykbashi - Për shembull, kemi KLP-në, që po e ndërtojmë tani si organ të ri me funksionet që ka. ILD-ja është organ i ri, nuk është organ që ekziston, por do të krijohet tani e të tjerë. Pra, dispozita transitorë duhet patjetër ta reflektojë këtë gjë.

Një element tjetër i rëndësishëm besoj se është edhe konfuzioni që ju shkaktoni nëpërmjet këtij propozimi në lidhje me atë që do të ndodhë me Gjykatën e Krimeve të Rënda. Ka bërë një punë të jashtëzakonshme gjatë gjithë këtyre viteve dhe gjithë problemeve të saj. Individët mund të kenë probleme, ka edhe reagime publike të tyre të formalizuara, qoftë të gjyqtarëve, qoftë të prokurorëve të Gjykatës së Krimeve të Rënda, të cilët kanë mbajtur një barrë të madhe përgjatë 10 vjetëve duke dënuar kriminelët, dhe sot, ne, i lëmë të paqartë. Kjo gjë duhet zgjidhur.

Në këndvështrimin tonë, ato çfarë diskutuam në pjesën e parë, në 12-13 nenet e para, janë sipërfaqësore, sepse ju garantoj, se deri ditën që ne të nënshkruajmë marrëveshjen, do të na duhet disa kohë. Zgjedhjet janë më keq nga çfarë kanë qenë ndonjëherë, të paktën dhe në 10-vjeçarën e fundit, deri sa të implementohet sistemi i drejtësisë dhe të japin produktin siç e presim të gjithë, - do t'i duhet ca kohë.

Të luftosh krimin e organizuar, do të marrë kohë, dhe kapitulli përkatës do të mbyllet në fund, të luftosh korrupsionin përtej gjyqësorit edhe më larg, do të marrë kohë dhe do të mbyllet i fundit si kapitull. Në të gjithë këtë histori, se çfarë ndodh me Bashkimin Europian, mbas

zgjedhjeve të Parlamentit Europian, apo mbas ndonjë traktati tjetër që mund të dalë, neve do të na duhet t'i rishikojmë ato dispozita, madje do të rishikojmë ato dispozita që janë ende pezull, me kusht për të hyrë në fuqi.

Për ne janë irelevante në këtë fazë, e për rrjedhojë, ne kemi një propozim konkret, teknikisht të shkruar në lidhje me këtë nen.

Fatmir Xhafaj- Faleminderit!

Atëherë, ju lutem, të fillojmë teknikisht me nenin. Me këtë që bëri zoti Bylykbashi, le ta konsiderojmë të mbyllur pjesën politike.

Ju thashë, nuk janë nene të lehta, t'i trajtojmë teknikisht si të tillë.

Zonja Hysi, ka kërkuar fjalën.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Fatmir Xhafaj- Vetëm, ju lutem, shumë shkurt.

Vasilika Hysi – Janë 13 paragrafë, tri variante.

1. Varianti origjinal,
2. Varianti i riparë,
3. Është një opsion.

Nga krahasimi i nenit 179 të tekstit të vënë në dispozicion dhe të një opsioni të mundshëm, konstatoj që i vetmi ndryshim lidhet me paragrafin e fundit, që bën fjalë për afatet e zgjedhjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Pjesa tjetër, midis dy varianteve të vëna, në ngjyrën kuq dhe blu, janë pothuajse të njëjta.

Lidhur me rregullimin që i bëhet mandatit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese për të vazhduar veprimtarinë e tyre si gjyqtarë, jam dakord me paragrafin e parë.

Kam një pyetje për ekspertët, të cilën e parashtrova kur diskutuam nenin 125 të projektit lidhur me “Ripërtëritjen”. Në paragrafin e 5-të të nenit 125, thuhet: “Gjykata Kushtetuese ripërtërihet çdo tre vjet me një të tretën e saj”, por, në variantin përfundimtar që ka ardhur për diskutim, mënyra se si do të ripërtërihet në këtë fazë tranzitore, është lënë jashtë. Ndërkohë, varianti i parë Ripërtëritja e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese”, ka qenë i rregulluar deri në detaje. Ky variant, në dijeninë time, që nga viti i kaluar ka qenë gati dhe nuk kuptoj nëse është lënë në harresë apo ka pasur ndonjë qëllim.

Do të sugjeroja ta kalonim paragraf për paragraf, dhe më pas të kalonim në çështjet e tjera.

Fatmir Xhafaj- Të lutem, i thuaj të gjitha çfarë ke, sepse ekspertët do të ndërhyjnë nëse ka nevojë.

Vasilika Hysi – Në këtë kuadër, do të sugjeroja që në dispozitën kalimtare të gjente rregullim Ripërtëritja e Gjykatës Kushtetuese në këtë periudhë tranzicioni, deri sa të ndodhë ripërtëritja e plotë e gjithë anëtarësisë.

Lidhur me paragrafet 3 dhe 4, ku flitet për vazhdimësinë e mandatit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, jam dakord, nuk duhet të ndryshohet. Po ashtu, edhe për funksionimin e Gjykatës së Lartë Administrative.

Për sa i përket paragrafit që flet për Tribunalin Disiplinor të Drejtësisë, duhet të bëjmë një saktësim, pasi ky tribunal, deri në 1 Janar të vitit 2020, nuk do të ketë në përbërjen e tij një anëtar nga Gjykata e Lartë Administrative. Në këtë kuadër, do të doja të bënim një saktësim të terminologjisë së numrit të gjyqtarëve që është përdorur, dhe duhet thënë: “në vend të një anëtari të Gjykatës së Lartë”, jo “në vend të tre anëtarëve të Gjykatës së Lartë”, duhet të jetë në përbërje kryetari i Kolegjit Administrativ aktual, në qoftë se ai do të kalojë procesin e vlerësimit.

Kam një pyetje për ekspertët lidhur me afatet kur është lënë ngritja e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Në draftin paraprak që i është paraqitur komisionit, ka qenë një afat 6-mujor. Më pas, në draftin e rishikuar, është thënë që “Brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, krijohet Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë”, pra, ka një lëvizje dy mujore. Cila është arsyeja që është zgjedhur ky afat nga 6 deri në 8 muaj dhe a është mbajtur parasysh që vitin tjetër ne kemi zgjedhje? Procesi i organizimit dhe ngritjes së gjithë këtyre institucioneve, do të ishte mirë të përfundonte dhe funksiononte sa më shpejt. Ndoshta ju keni arsye dhe e lidhni edhe me procesin e vlerësimit, por kjo është një pyetje që unë kisha.

Gjithashtu, lidhur me gjyqtarët që transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, ju thoni që gjyqtarët e këtyre gjykatave do të transferohen në gjykatat e tjera, në rast se ata nuk përfundojnë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë. Mendoj që kjo është një lapsus, sepse në rast se një gjyqtar nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë, ai nuk e meriton të kalojë në gjykatat e tjera. Ai do të ikë nga sistemi. Ky duhet të jetë kuptimi. Nëse gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, e kalojnë me sukses këtë proces dhe do të pranojnë të kontrollohet në mënyrë periodike pasuria e tyre, telekomunikimi i tyre, të

verifikohen llogaritë bankare të tyre dhe të familjarëve, atëherë ata mund të vazhdojnë ose të transferohen në gjykatat e tjera.

Nuk duhet të pranojmë të transferohen në gjykatë, persona të cilët nuk e kalojnë procesin e vlerësimit të pastërtisë dhe atë të profesionalizmit të tyre.

Flitet për krijimin e një Prokurorie të Posaçme, por çfarë do të bëhet me prokurorët aktualë. Ndoshta për këtë duhet të shprehemi.

Dhe e fundit, ju keni thënë që Inspektori i Lartë i Drejtësisë, emërohet brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Pyetja që unë kam lidhet me afatin. A është i mjaftueshëm ky afat që keni vënë? Këto ishin disa nga pyetjet që kisha.

Për sa i përket përbërjes së Këshillit të Lartë të Emërimeve, që është rregulluar në paragrafin e 13 të kësaj dispozite kalimtare, i qëndroj variantit që diskutova kur folëm për Këshillin e Lartë të Emërimeve, që duhet të jetë shkencor, akademik, sikurse është paraqitur në variantin që i kemi dërguar Komisionit të Venecias.

Nëse mendoni se duhet të kalojmë edhe te neni tjetër, mendoj se është nen i gjatë dhe është më mirë të marrin përgjigje këto pyetje brenda këtij neni.

Fatmir Xhafaj – Ju faleminderit!

Do të kërkoja mirëkuptimin tuaj për 10 minuta pushim, sepse duhet që së bashku me kolegët tanë europarlamentarë , të votojmë rezolutën, pasi duhet vota jonë.

Pjesa e dytë

Fatmir Xhafaj – Rifillojmë mbledhjen.

Pra, mbyllëm votimin nga komiteti i përbashkët BE-Shqipëri, duke votuar rezolutën në mënyrë unanime. Tani besoj ka ardhur koha të votojmë reformën në mënyrë unanime.

Atëherë, besoj se zoti Rainer do të japë përgjigje për komentet e bëra nga kolegja Hysi dhe nga kolegët në tërësi.

Po, zoti Deville.

Rainer Deville - Shumë faleminderit! Në të vërtetë neni 179 është një ushtrim i ndërlikuar për të zbatuar gjithë sistemin dhe shohim që shumë ndikime të ndryshme na vijnë së bashku. Në nenin 179/2 për anëtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese, fillimisht kemi pasur elementin kohë si ta bëjmë atë dhe kjo paraqet një opsion. Por, vështirësia qëndron se kur një anëtar i Gjykatës Kushtetuese mund të japë dorëheqjen apo bie jashtë procesit të vettingut, në momentin që kjo ndodh dhe ju keni një afat kohor të rreptë, ky afat kohor mund të zhduket natyrisht. Pra, ajo që na duhet ne në vend të një afati është të kemi një renditje/rregull, sepse ne nuk e dimë se kur dhe për çfarë arsye dikush mund të largohet nga Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye, ne kemi menduar që pika 2 është më fleksibël, sepse ne nuk mund ta parashikojmë gjithsesi se çfarë do të ndodhë. Në momentin që dikush po largohet nga Gjykata Kushtetuese, ky person duhet të zëvendësohet menjëherë. Ky është kuptimi pas kësaj.

Në pikën 4 dhe 5 Gjykata e Lartë Administrative që krijohet në vitin 2020... Kjo është e bazuar në supozimin që ju të shkoni drejt një Gjykate të Lartë Administrative, se në qoftë se ju nuk e bëni atë, atëherë sigurisht ky parashikim nuk vlen. Në rast se kjo gjykatë themelohet në vitin 2020, atëherë nga 2020 e poshtë kjo nuk qëndron, por ne i referohemi panelit administrativ aktual të Gjykatës së Lartë i cili shërben funksionin sot. Pra, kjo është thjesht një ndërhyrje për të zëvendësuar Gjykatën e Lartë Administrative për aq kohë sa ajo nuk ekziston, kjo është vetëm një çështje teknike.

Për Këshillat askush nuk pa zgjedhjet, e dëgjova sot këtë shqetësim. Arsyeja pas kohës është thjesht teknike. Përsëri kemi pasur vështirësi që kemi procesin e vettingut të parin. Dhe në procedurat e vettingut do të shohim se ne kemi nevojë për të vendosur së pari komisione, pastaj vjen monitorimi dhe të tjera gjëra me radhë. Pastaj ne mund të krijojmë Këshillin e Emërimeve dhe më pas bëjmë përzgjedhjet dhe selektimet për Këshillat e tjerë. Ne u përpoqëm për të parë se cili është afati kohor realist për të shkuar në të gjitha këto sa më mirë të jetë e mundur. Nëse i referohemi procesit të vettingut, ai është programuar që të jetë sa më i shpejtë, por ai përsëri merr kohë.

Për Gjykatën e Krimeve të Rënda dhe gjyqtarët që punojnë atje, pika 9, ju duhet ta lexoni se gjyqtarët do të transferohen vetëm nëse ata dështojnë të kalojnë testin. Dhe kjo është pjesë e filozofisë që njerëzit që ulen aty duhet të jenë njerëzit e duhur. Kjo është ajo që ne të gjithë kemi rënë dakord. Nëse ata dështojnë ne kemi dy kontrole, ndër të cilët është ai i vettingut. Sipas ligjit, gjyqtarët që gjykojnë në këtë gjykatë duhet të shihen që janë seriozë dhe ata njerëz

që nuk janë të gatshëm për të rënë dakord me këto standarde - që ne i kemi marrë nga USKOK-u, - atëherë duhet të mos jenë atje. Kjo është një tjetër dispozitë kalimtare, ata persona që nuk janë të denjë duhet që të largohen. E njëjta gjë është për Prokurorinë.

Në pikën 13 është sërish e njëjta pyetje, si do ta organizojmë dispozitën tranzitore. Pra, një alternativë është që të fshini numrin 13 tërësisht, dhe atëherë ju jeni në sistemin e vjetër ku duhet të shkoni hap pas hapi: së pari procesi i vetingut, nxjerrja e kandidatëve që kualifikohen, krijimi i Këshillit të Emërimeve, etj. Një opsion që kemi ofruar këtu është që ta bënim atë të shpejtë. Sigurisht që kjo zgjidhje nuk përfaqëson një zgjidhje cilësore kushtetuese afatgjatë, por është një zgjidhje e shpejtë për një dispozitë kalimtare. Unë ju kuptoj nëse ju niseni nga vizioni shkencor dhe thoni që nuk ju pëlqen dhe do donit të shkonit te sistemi standard. Fundja ju mund ta bëni këtë, por të paktën ky është një opsion që ju mund të kenë. Ndoshta Jon mund të flasë për prokurorët dhe dispozitat kalimtare të tyre dhe mund t'ju japë disa mendime të tjera.

Jon Smibert – Në fakt, unë do të thoja disa gjëra si fillim. Për dy Këshillat, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, puna më e madhe është bërë kryesisht muajt e fundit. Unë mendoj se 6 muaj me procesin e vetingut që ndodh para krijimit të tyre, është me të vërtetë një kohë e shkurtër, sepse kjo nuk përfshin vetëm zgjedhjen e njerëzve dhe sigurimin e kompjuterëve, por është më shumë se kaq. Unë e di nga Kroacia dhe Këshilli Prokurorial në Kosovë se ky është një proces shumë i gjatë, ku ju do të përpiqeni të ndërtoni institucione të forta.

Aspekti i dytë i kësaj ka të bëjë me paragrafin 9, dhe pyetja juaj ishte për transferimin e gjyqtarëve ekzistues, nëse ata dështojnë të kalojnë kontrollin e figurës dhe të pasurisë ose refuzojnë ti nënshtrohen kontrollit periodik. Unë mendoj se ju nuk mund të dënoni ata që refuzojnë kontrollin apo ata anëtarët e familjes të së cilëve refuzojnë të pajtohen me këtë. Nuk mund të thoni se ata nuk mund të jenë gjyqtarë/ prokurorët, ata thjesht nuk mund të jenë gjykatës dhe prokurorë në këtë zyrë, edhe nëse ata dështojnë për të kaluar kontrollin e figurës dhe të pasurisë. Kjo është një dispozitë kalimtare, nuk përfaqëson një faj final të subjektit. Ne nuk mund të nxjerrim nga ligji fajësinë e dikujt, por kjo ama shërben për ti shkarkuar ose pezulluar. Do jetë procesi disiplinor ai që do vendosë lidhur me këtë.

Prokurorët nuk janë përfshirë këtu, sepse dihet gjithmonë që gjyqtarët kanë një cilësi të caktuar kushtetuese ndryshe nga prokurorët duke pasur parasysh për shembull emërimin. Por, jo se prokurorët janë harruar. Thjesht është arsyetuar se kjo pjesë e lidhur me prokurorët ndoshta

nuk është e nevojshme të jetë në Kushtetutë, por në ligj. Por mund të vihet edhe në Kushtetutë nëse është e nevojshme.

Një gjë që kërkoj të them në lidhje me dispozitën tranzitore të Këshillit të Emërimeve. Brenda dy ose tre vjetëve pasi të jetë ngritur ky institucion, çdo gjë do duket në rregull, por gjatë muajve të parë ka shumë gjëra për të filluar. Këshilli i Emërimeve duhet të jetë për të përzgjedhur disa njerëz që të jenë pjesë e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe atij të Prokurorisë. Kjo është metodologjia për të krijuar Këshillin e Emërimeve, i cili do të veprojë për një periudhë të shkurtër kohore dhe do të shikohet nga Ombudsmeni - kjo ishte diçka e përmendur në bisedat me Komisionin e Venecias, të cilët po ashtu shprehën shqetësime lidhur me dispozitën kalimtare. Kjo nuk është diçka e shkruar në opinionin e Komisionit të Venecias, por duke qenë se e kanë përmendur vazhdimisht ne kemi menduar për ta pasqyruar këtu.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

E mbyllim këtu diskutimin për këtë nen.

Vazhdojmë me nenin 58.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të bëni propozim alternativ mbi propozimin e ekspertëve? Dakord.

Zoti Bylykbashi dëshiron të paraqesë një propozim alternativ mbi propozimin e ekspertëve.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, sigurisht që reflektohet ajo që unë thashë pak më parë.

Neni 179 ndryshohet si më poshtë:

1. Data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në datën 1 shtator 2017. Kuvendi në emërimin e kuotave të tij për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për prokurorin e Përgjithshëm, si dhe për emërimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vendos me 2/3 e votave.

2. Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese vazhdojnë veprimtarinë e tyre si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese sipas mandatit të mëparshëm.

Anëtari i parë për t'u zëvendësuar në Gjykatën Kushtetuese emërohet nga Presidenti i Republikës, i dyti emërohet nga Kuvendi dhe i treti emërohet nga Gjykata e Lartë. Kur mandati i një anëtari përfundon përpara afatit, ruhet renditja e emërimit sipas kuotave të përcaktuara në nenin 125 të Kushtetutës.

3. Anëtarët e Gjykatës së Lartë vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e tyre sipas mandatit të mëparshëm. Gjyqtarët e rinj që zëvendësojnë gjyqtarët, të cilëve u mbaron mandati, emërohen sipas dispozitave të këtij ligji.

4. Këshilli i Lartë Gjyqësor krijohet brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Tre anëtarët gjyqtarë dhe 2 anëtarët jogjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohen fillimisht për një mandat 3-vjeçar, me qëllim përtëritjen e pjesshme të këtij organi.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë vazhdon veprimtarinë e tij deri në momentin e përfundimit të mandatit të Presidentit të Republikës.

5. Këshilli i Lartë i Prokurorisë krijohet brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Tre anëtarë prokurorë dhe 2 anëtarë joprokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë emërohen fillimisht për një mandat 3-vjeçar, me qëllim përtëritjen e pjesshme të këtij organi.

6. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda emërtohen, funksionojnë dhe ushtrojnë kompetencat e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Gjykatës së Apelit sipas paragrafit 1, të nenit 143.

Regjimi transitor i çështjeve gjyqësore në gjykim bëhet sipas ligjit.

Gjyqtarët në detyrë pranë këtyre gjykatave transferohen në gjykata të tjera në rast se refuzojnë të japin miratimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre financiare dhe telekomunikimeve personale të tyre, si dhe ato të familjarëve të tyre të afërt.

7. Prokuroria e Posaçme krijohet sipas nenit 149/3 dhe prokurorët pranë saj emërohen brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë sipas këtij ligji. Regjimi tranzitor i procedimeve penale në hetimin paraprak dhe në ekzekutimin nga prokuroria pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda të prokuroria e posaçme bëhet sipas ligjit.

8. Inspektori i Lartë i Drejtësisë emërohet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Transferimi i të dhënave të dokumentacionit të nevojshëm nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit tek Inspektorati i Lartë i Drejtësisë kryhet sipas ligjit.

9. Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë vazhdojnë të ushtrojnë detyrën dhe janë subjekt i procesit të vlerësimit kalimtar të kualifikimit sipas nenit 179/2.

Fatmir Xhafaj – I'a plotësuam dëshirën edhe zotit Bylykbashi ta lexonte.

Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Pika 13 e këtij neni të jetë në funksion të sistemit fiks që propozova te Këshilli i Emërimeve të Drejtësisë.

Më lejoni të nënvizoj një fakt, që e ngriti zonja Hysi, atë të afatit të krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor brenda 8 muajve, unë do të insistoja të ishte 6 muaj, po ashtu edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pika 8, të paktën të ishte 6 muaj.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

E mbyllim këtu.

Vazhdojmë me nenin 58.

Po, zonja Hysi, të lutem shumë shkurt, të koncentruar, pra vetëm detajet teknike.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Këto janë dispozita kalimtare dhe do të jem koncize.

Unë kam një pyetje në lidhje me rregullimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 179/b, konkretisht me shtesën që është bërë nga ekspertët e huaj.

Në pikën e parë ju keni shtuar ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative dhe ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, të cilët i nënshtrohen procesit të rivlerësimit. Nëse rivlerësimi kryhet me sukses, në paragrafin tjetër ju thoni: “Ata vazhdojnë të ndjekin programe trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës”. Cili ka qenë qëllimi, kuptimi? Këta do të vazhdojnë të qëndrojnë në pozicionin që janë, apo kanë të drejtë të konkurrojnë për të abdetuar pozicionin e tyre?

Pyetja e dytë ka të bëjë me ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, të cilët nëse dëshirojnë, do t’ i nënshtrohen rivlerësimit për të plotësuar kriteret dhe më pas “këta”, thoni ju përsëri: “i nënshtrohen trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës”. E keni fjalën që do të bëjnë trajnim apo do të bëjnë shkollë të plotë?

Kam edhe një pyetje në lidhje me paragrafët 4 dhe 5.

Është shumë i drejtë rregullimi që ju keni bërë që procedura e rivlerësimit duhet të fillojë nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe nga prokurori i Përgjithshëm, por mendoj se në Kushtetutë duhen theksuar parimet, pra të heqim pjesën morale që duhet të kryhet pa vonesë, me sa më me efikasitet, por vetëm të theksojmë që procedura e rivlerësimit duhet të respektojë të drejtat, liritë themelore të njeriut, parimin e personalitetit dhe të drejtën e ankimit.

Në paragrafin e 5-të ju keni parashikuar dy afate:

Komisioni i pavarur i Kualifikimit dhe Komisioni Publik pushojnë së funksionuari pas 5 vjetësh, ndërkohë që për Kolegjin e Posaçëm të Kualifikimit keni thënë se pushon së funksionuari pas 9 vjetësh. Cila është arsyeja e kësaj difference kaq të madhe në vite midis kohëzgjatjes së funksionimit të këtyre komisioneve? Pas shpërbërjes së Komisionit Publik, përse është përzgjedhur drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, si personi përgjegjës, i cili do të shqyrtojë ankimet?

Këto ishin pyetjet që unë kisha për këtë ligj.

Më kanë lindur këto pyetje, sepse në dispozitat kalimtare ne duhet të kemi një grup të mirë personash, të cilët do të jenë në gjendje të plotësojnë vendet vakante që mund të krijohen nga procesi i vlerësimit, por, nga ana tjetër, do të jetë e rekomandueshme që të përcaktohet qartë në dispozita se kush do t'i nënshtrohet trajnimit në Shkollën e Magjistraturës.

Besoj se këtu bëhet fjalë për ata persona që janë ndihmës ligjorë apo ndihmës pranë Gjykatës Administrative, ose Prokurorisë së Përgjithshme, apo persona, të cilët kanë qenë ish-gjyqtarë dhe ish-prokurorë, për të cilët është i nevojshëm përditësimi i njohurive, pra duhet bërë një dallim të tillë, pasi besoj se një gjyqtar i gjykatës që është magjistrat, që kalon procesin e vlerësimit, nuk mund të ketë nevojë t'i nënshtrohet përsëri trajnimeve në Shkollën e Magjistraturës.

Ky keqkuptim ose ky kuptim i dyfishtë rrjedh nga fakti se ju në paragrafin e parë keni shtuar disa subjekte që nuk janë magjistratë. Këtu do të doja të bënim një dallim, në qoftë se e kam kuptuar qartë.

Lidhur me çështjen e dytë, sugjerimi im për afatet, ndoshta ju keni argumente të tjera, është: periudha e funksionimit të këtyre dy komisioneve nuk duhet të ketë diferencë kaq të madhe, 5 dhe 9 vjet. Ndoshta duhet parë për ta shkurtuar kohëzgjatjen e tyre.

Për sa i përket pyetjes se përse shqyrtimi i procedurave i kalon pikërisht drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, unë nuk jam në gjendje ta komentoj, por më tërhoqi vëmendjen dhe e kam si pyetje për hartuesit e këtij propozimi.

Fatmir Xhafaj – Po, faleminderit!

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Pa hyrë në shumë detaje, këto komente janë bërë edhe më parë. Ne mendojmë se kjo është pjesë e rëndësishme, ndërkohë që vetingu është elementi thelbësor që duhet të ketë kjo reformë. Vetingu duhet të jetë i plotë, i detajuar dhe të mos lërë hapësira që

elementet e korruptuar apo të paaftë të vazhdojnë të qëndrojnë në sistem, pra, thënë kjo, ne jemi që sistemi të jetë funksional, efikas dhe i thjeshtuar.

Për këtë arsye kemi rikonceptuar mënyrën e bërjes së vetingut. Ne propozojmë një shkurtim, ashtu siç do të thotë edhe Komisioni i Venecias, të afatit gjatë të cilit kjo do të kryhet. Në propozimin tuaj ju shtoni dy instrumente të reja në sistemin kushtetues për të bërë këtë punë, ndërkohë ne mendojmë se sistemi i ri, që në momentet e para që fillon, duhet të jetë i pastruar në kokën e vet, të fillojë dhe të ushtrojë këto funksione drejtpërdrejtë, në mënyrë që të mos kemi dy struktura paralele, (njëra që e bën tani e në të shkuarën dhe tjera që e bën tani e në të ardhmen), të cilat do të funksionojnë në mënyrë paralele për një periudhë të caktuar. Kemi të gjithë mundësinë që t'ia transferojmë drejtpërdrejtë një KLGJ-je dhe KLP-je të pastruar, të vetuar, pra t'i transferojmë atë kompetencë që do ta kryejë në të ardhmen me një kalendar të qartë, të përcaktuar në mënyrë rigorozë dhe të monitoruar edhe nga ndërkombëtarët.

Nuk dua të hyj në detaje të tjera, për efekt kohe, zoti kryetar, por janë një seri elementesh, të cilat ne gjykojmë se duhet të rishikohen dhe të rikonceptohen në këtë pjesë.

Për ta bërë më të thjeshtë po bëj propozimin konkret. Për këtë nen, ne sugjerojmë:

1. Gjyqtarët dhe prokurorët e Shkallës së Parë dhe të Apelit, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, prokurori i Përgjithshëm dhe prokurorët pranë Prokurorisë së Përgjithshme, që janë në detyrë, inspektorët dhe inspektori i KLD-së, si dhe të gjithë ata që ruajnë statusin e gjyqtarit apo të prokurorit, i nënshtrohen një procesi të posaçëm rivlerësimi profesional dhe moral.

2. Procesit të posaçëm të rivlerësimi profesional dhe moral i nënshtrohen edhe të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi.

3. Procesit të posaçëm të rivlerësimi profesional dhe moral i nënshtrohen edhe anëtarët e Gjykatës Kushtetuese.

4. Procesit të posaçëm të rivlerësimi profesional dhe moral i nënshtrohen edhe të gjithë anëtarët e zgjedhur apo të emëruar pas hyrjes në fuqi të këtij ligji në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, në njësinë e posaçme hetimore si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët që emërohen në detyrë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Përfundimi i procesit të posaçëm të rivlerësimi dhe vërtetimi i aftësisë profesionale dhe pastërtisë morale të anëtarit të zgjedhur apo të emëruar është kusht për fillimin e detyrës për funksionarët që i nënshtrohen procesit të posaçëm të rivlerësimi dhe që nuk kanë ushtruar deri

në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji detyra në institucionet e parashikuara në paragrafët 1 deri 3 të këtij neni. Për vlerësimin profesional zbatohen *mutatis-mutandis* rregullat e vlerësimit profesional të nenit 6, të pjesës bashkëlidhur këtij ligji.

5. Vetëm subjektet e parashikuara në paragrafët 1 deri në 3, që përfundojnë me sukses procesin e rivlerësimit profesional e moral vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë.

6. Procesi i rivlerësimit kryhet pa vonesë dhe sa më me efikasitet që të jetë e mundur, duke garantuar në të njëjtën kohë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore, për aq sa janë të zbatueshme në kuadër të rivlerësimit, procesit të rregullt ligjor, parimit të proporcionalitetit dhe të drejtës së ankimit.

7. Rivlerësimi kryhet:

a) nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, për gjyqtarët e Shkallës së Parë dhe të Apelit, për inspektorët dhe për kryeinspektorin e KLD-së, si dhe për të gjithë ata që ruajnë statusin e gjyqtarit.

b) nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për prokurorin e Përgjithshëm, për prokurorët pranë prokurorisë së Përgjithshme, për prokurorët e Shkallës së Parë dhe të Apelit, për oficerët e njësisë së posaçme hetimore, si dhe për të gjithë ata që ruajnë statusin e prokurorit.

c) nga komisioni i vëzhguesve ndërkombëtarë për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, për anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për inspektorin e Lartë të Drejtësisë, si dhe për anëtarët e KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi.

8. Rregullat e hollësishme të realizimit të procesit të posaçëm të rivlerësimit përcaktohen në pjesën bashkëlidhur këtij ligji, e cila është pjesë përbërëse e tij deri në datën 31 dhjetor të vitit 2022, si dhe në ligjin e posaçëm të dalë në bazë dhe për zbatim të saj.

9. Pas datës 31 dhjetor 2022, vlerësimi i aftësive profesionale dhe i pastërtisë morale të funksionarëve, e përcaktuar në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, bëhet sipas rregullave të përgjithshme të përcaktuara në Kushtetutë. Ky është propozimi që kemi ne për këtë nen. Te kjo ndër të tjera çon dhe në thjeshtimin e arkitekturës së sistemit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Deville.

Rainer Deville – Komenti i parë është që ju keni tre burime legjislative: keni nenin 179/b ku jepet ideja e përgjithshme e vetingut, keni aneksin të përbërë nga dispozita më të hollësishme si dhe së fundmi keni ligjin implementues. E gjithë ideja e vetingut ka të bëjë me një

kontroll nga jashtë sistemit ku të gjithë brenda sistemit i nënshtrohen kontrollit për të rifituar besimin. Pra, nëse ju thoni që Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me anëtarët aktualë që po ushtrojnë funksionet mund të kontrollojnë sistemin, jeni duke biseduar për një ushtrim tjetër, por ju nuk po flisni për Reformën në Drejtësi në kuptimin si ne e kemi projektuar atë. Në nenin 179 / b unë pajtohem me diskutimet që kemi 3 grupe të ndryshme njerëzish dhe ndoshta duhet ta bëjmë më të dukshme formulimin teknik.

Një, janë gjyqtarët dhe prokurorët e sistemit aktual të cilët shkojnë përmes sistemit të vetingut. Grupi i dytë janë ata që janë po ashtu brenda sistemit të tillë si këshilltarët ligjorë ose të tjerë që kryejnë funksione të ngjashme. Edhe këta njerëz duhet ti nënshtrohen një vlerësimi sepse sipas Ligjit për Statusin, ata kanë të drejtë të bëhen gjyqtarë/prokurorë, por që të bëhen të tillë duhet të kenë të njëjtat kualifikime dhe të kenë kaluar nga Shkolla e Magjistraturës. Cili grup prej tyre duhet t'i nënshtrohet cilit cikël të studimeve, cilit provim, etj. këto janë çështje që do të rregullohen nga ligji. Por në fund ne nuk duam të shohin ndihmësit ligjorë që të shkruajnë vendimet për një gjyqtar, por duhet të jetë gjyqtari vetë. Ky është arsyeimi dhe unë pajtohem që për pikën 1 dhe 2 duhet këto tre grupe duhet të parashikohen më dukshëm të strukturuar. Arsyeja e dytë pse kemi përfshirë ndihmësit është për të plotësuar vendet e lira si rezultat i sistemit të vetingut. Pyetja se sa njerëz do të pushohen nga puna, është një pyetje e drejtë për të rekrutuar njerëz mjaftueshëm me përvojë dhe unë e di që njerëzit që punojnë në gjykatë janë ndoshta mjaftueshëm të mirë për t'u bërë gjyqtarë/prokurorë. Ne vetëm duhet të sigurohemi që ata t'i nënshtrohen të njëjtin sistem cilësie si gjithë të tjerët.

Të drejtat themelore të njeriut të përfshira në pikën 3 dhe 4, u përpoqëm për t'i vënë atje si parim. Gjatë kësaj kohe Komisioni i Venecias na ka dhënë disa parime. Në pikën 5 ne kemi parimin që gjyqtarët duhet të kenë një kohëzgjatje të plotë dhe pozicionin e duhur si gjyqtar. Pra, nëse ne i referohemi gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, ata duhet të kenë afatin 9 vjet. Parimi i dytë është se kur këto institucione mbarojnë së paturit efekt, kjo nuk do të thotë që të gjitha rastet janë finalizuar. Ne nuk e dimë se sa kohë do të zgjasë një çështje por ne mund të caktojmë se ku mund të adresohet rasti në shkallë të parë dhe më tej. Komisioneri Publik në sistem ka funksionin për të apeluar kështu që ne menduam se kjo mund të bëhej nga një prokuror dhe më tej ne kemi arsyetuar se prokuroria e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar është më e duhura për këtë sepse ka përvojë më të madhe për ta bërë. Këto janë parimet e përgjithshme, rregullat e detajuara gjenden në aneks dhe në ligjin përkatës.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Po, zoti Smibert.

Jon Smibert – Gjatë gjithë eksperiencës me Komisionin e Venecias, kjo është pjesa ku ata shpenzuan shumicën e kohës së tyre, duke marrë në konsideratë përvojën që kanë pasur në Ukrainë, duke marrë parasysh përvojat në Kosovë ku e kanë bërë këtë si dhe duke marrë parasysh përvojat në Serbi ku u përpoqën për ta bërë. Pra, nisur nga bërja bashkë e gjithë këtyre përvojave, ajo që dua të them është se këtu kemi të bëjmë me një rezultat të ardhur nga mendime ndërkombëtare të reflektuara mirë. Kështu që unë mendoj se riformulimi ose rishqyrtimi i kësaj pjese të veçantë duhet të trajtohet me kujdes sepse para së gjithash kjo përfaqëson një demonstrim të angazhimit të Shqipërisë për reformën e vërtetë, por për më tepër kjo është edhe pjesë e një partneriteti ndërkombëtar sepse vëzhguesit e huaj do të jenë pjesë e këtij procesi. Për këtë arsye, një riformulim substancial se si do të jetë procesi, pa pranuar të gjitha diskutimet dhe këshillat e Komisionit të Venecias, mbi të cilat u mbështet BE dhe USA, duhet trajtuar me kujdes.

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Nuk e di nëse ka qenë problem përkthimi. Pra, pa vënë përgjegjësi askund, edhe një herë dua të sqaroj për zotin Deville se bëhet fjalë që vetingu për gjyqtarët do të bëhet në propozimin tonë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, organi i ri, jo Këshilli i Lartë i Drejtësisë që është sot. Ajo që ne propozojmë është që përmes një procesi rigoroz dhe të monitoruar ndërkombëtarisht drejtpërdrejt me aksesin që sot parashikohet te kjo fazë, te pastrimi i majave të institucioneve, ne vëmë në funksion organet kryesore dhe do të jenë këto që më pas do të bëjnë atë punë që parashikohet ta kryejnë pas disa vitesh. Ndoshta edhe pas 5, 6 apo 7 vjetësh mund të kemi një kthim mbrapsht të procesit për shkak se e marrin në dorë, autoritetet janë parashikuar për më vonë. Këtë të supozojmë ne? Që këta nuk do të jenë në gjendje ta bëjnë? Atëherë çfarë e pengon të kthehet mbrapsht?

Pra, ne po ndërhyjmë sot dhe po e pastrojmë majën dhe zemrën e sistemit dhe i japim detyrën për të bërë atë detyrë që do të bëjnë dhe më vonë, atë detyrë që do të bëjnë edhe për të ardhmen, jo vetëm për të shkuarën. Kështu që më shumë se sa ta rëndojmë perceptacionin për sistemin e drejtësisë, siç është edhe sot i rënduar, e thotë dhe Komisioni i Venecias, le ta forcojmë dhe t'i japim besim që fillimi është ai i duhuri. Vetingu pa asnjë ekuivok duhet të jetë po aq i fortë sa në çdo draft që ne parashikojmë, por ta bëjmë funksional.

Ndërkohë duhet të kemi parasysh dhe një gjë, që e thotë Komisioni i Venecias dhe nuk e dimë se kush ua ka thënë ndryshe. Shqipëria nuk ka resurset e mjaftueshme për të mbajtur, jo vetëm në aspektin financiar që do të jetë i kushtueshëm, por dhe në aspektin e burimeve njerëzore, që do të duhet të konsumojë për funksionarë të lartë për një periudhë, siç parashikohet deri në 9 vjet, për të kryer këtë detyrë. Nëse ne kemi figura kaq të mira, që nuk i kemi shumë, deri më sot prova është që nuk kemi pasur lehtësi për të gjetur kandidatura, t'i përdorim për ato elemente të sistemit të cilat do të jenë pjesët funksionale të sistemit. Dhe këtë detyrë t'ia japim KLGJ-së dhe KLP-së për pjesën që është nën to.

Ndërkohë me strukturën që propozojmë ne pastrohet Gjykata Kushtetuese, KLGJ-ja, KLP-ja, ILD-ja. Pra, pastrohen nga problemi që ne sot e konsiderojmë si problem jetik i sistemit. Kështu që duke sqaruar atë problem, ndoshta të keqkuptimit kush është organi dhe duke e rishpjeguar mekanizmin besoj se është shumë e rëndësishme që të gjithë ne të kemi besim që këtë punë do ta marrim përsipër ta bëjmë ne, ky sistemi i ri që po ngremë në këmbë dhe të mos krijojmë struktura paralele të cilat funksionojnë me vite. Ka pak eksperiencë dhe akoma nuk mund të thuhet që është e suksesshme në këtë model. Është e rëndësishme që të bëjmë një gjë që do t'i funksionojë modelit tonë, që është model evropian në fund fare. Nuk besoj se ajo që propozojmë ne heq ndonjë nga elementet thelbësore të vetingut për mënyrën se si funksionon, ajo që do të na duhet ne për të hyrë në BE, por në çdo rast do të na duhet ditë për ditë deri sa të hyjmë në BE.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Unë dua të bëj dy komente. Unë bie shumë dakord me gjykimin e dy zotërinjve të nderuar, zotit Deville dhe Smibert që këtu ka një investim të drejtpërdrejtë dhe të kujdesshëm të Komisionit të Venecias dhe që ndërhyrja në këto nene duhet të jetë një gjë shumë serioze, sepse ndër të tjera ka të bëjë dhe thelbësisht me procesin e vetingut aq të domosdoshëm, por dhe aq të gjithëpranuar nga kjo tavolinë dhe me gjerë. Kështu që në këtë sens ajo çfarë është sot në projekt është një gjë shumë e mirë. Siç e thatë edhe ju, ka disa gjëra që duhen parë me kujdes që të pastrohen nga pikëpamja teknike.

Për sa i përket çështjes së burimeve njerëzore në fakt është pak miopi edhe politike, edhe intelektuale. Të thuash që nuk ka burime njerëzore në këtë vend por nëse do t'i matësh me militantët partiakë mund të mos ketë burime njerëzore, ose me këndvështrime të ngushta mund të mos ketë burime njerëzore. Nëse do të shohim të gjithë ata djem dhe vajza të reja që kanë

studiuar, janë përgatitur gjatë gjithë këtyre 25 vjetëve, janë shkolluar, janë kualifikuar jashtë shtetit, janë trajnuar apo punojnë jashtë shtetit, apo kanë nguruar t'i shkojnë administratës publike apo shumë më mirë akoma partive politike unë besoj se ka shumë njerëz. Çdo lloj nihilizmi ndaj të gjithë kësaj pasurie që ka krijuar vendi në këto vite është i dëmshëm. Çfarë do të bëjnë këta që janë këtu?

Së pari, një herë këta do të punojnë me partnerët ndërkombëtarë dhe për këta kjo do të jetë një shkollë e dytë. Kur të mbarojnë këtë shkollë, këtë praktikë të dytë kaq të dobishme, unë besoj që do të jenë një burim shumë i rëndësishëm edhe për vetë sistemin e drejtësisë. Kështu që nga kjo pikëpamje le t'u japim mundësi, mbështetje dhe të mos kemi merakun se nuk ka djem dhe vajza në Shqipëri që mund të bëjnë punë kaq të mira, kaq profesionale dhe kaq të përgjegjshme. Nuk ka pasur vizion për t'i respektuar, për t'i vlerësuar, për t'i mbështetur dhe për t'i promovuar ata.

Kjo është pikëpamja ime që besoj se në ditët në vijim do të kem mundësi ta them dhe më konkretisht.

Gent Strazimiri - Po jap dhe unë pikëpamjen time në mbështetje të asaj që tha zoti Xhafaj dhe zoti Bylykbashi. Besoj se ju thatë të njëjtën gjë, vetëm se ne ndahemi në atë mungesën e besimit të ndërsjellë se çfarë kuptoni ju me ato që thoni dhe çfarë kuptojmë ne me ato që themi. Duke pasur parasysh një histori të tërë mosbesimi, mosinqeriteti, varianti që ne propozojmë është më efikas, ashtu sikurse jua tha dhe zotit Bylykbashi, buron nga eksperiencia, nga tradita, nga deformimet që ka sjellë realiteti në Shqipëri. I parë teorikisht në kushte laboratorike ky është një variant shumë i mirë edhe ky që kemi përpara. Por ne nuk mund të mos fusim në formulë për ta nxjerrë në vlera nominale, traditën, deformimet, keqformimet e qëllimshme ose jo të cilat sigurisht ekzistojnë ende sot se në këtë ambient po përpiqemi të rregullojmë.

Gjatë këtyre 25 vjetëve eksperiencia e vyer e partnerëve ndërkombëtarë ka qenë prezente, asistenca shumë e vyer financiare dhe teknike ka qenë prezente. Nuk na ka ndaluar të bëjmë paudhësitë për të krijuar këtë sistem që kemi. Kështu që edhe asistencës së vyer, shkollës së dytë që do të bëhet pas kësaj reforme në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, unë sigurisht i jap një valencë ndryshe nga ajo e zotit Xhafaj, për të qenë krejtësisht i sinqertë dhe për të qenë me këmbë në tokë. Vazhdoj të mbështes variantin tonë që është më realist. Kryen të

njëjtat funksione në mënyrë më ekonomike, më pak komplekse, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe sigurisht më efikase.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Unë dëshiroj të falënderoj ekspertët ndërkombëtarë për përgjigjet që kanë dhënë sot, pasi vërtet ka qenë kapitulli më delikat që ka të bëjë me momentin e tranzicionit dhe të ndërtimit të institucioneve të reja. Për më tepër dëshiroj të nënvizoj një fakt jo thjesht për të bërë një deklaratë. Ne jemi njerëz që merremi me politikë në fund fare. Por nuk mund ta konsiderojmë veten si ekspertët më të mirë juristë të së drejtës kushtetuese qoftë në Shqipëri, qoftë dhe më gjerë. Kështu që do të ripërsërisja dhe një herë vlerësimin tim për opinionin e ekspertizës ndërkombëtare që është dhe pjesë e bashkëpronësisë të këtij projekti dhe të një pune 1 vit e gjysmë rreth këtij projekti.

Sigurisht do t'u kërkoj kolegëve të opozitës që ta rikonsideronin dhe një herë atë që kemi thënë që në fillim të dyja palët, që kur kemi opinione të ndryshme, atëherë do të kërkojmë gjykimin fundor të ekspertëve ndërkombëtarë. Megjithatë kjo mbetet në vullnetin politik të gjithsecilit. Unë mendoj që kemi bërë një punë shumë të mirë, sidomos në zbulimin më në fund të qartë të koncepteve tona lidhur me këtë reformë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Zoti Xhafaj, duke qenë se nuk e ke pasur fatin në vitin 1998 të ishe pjesë e procesit kushtetues, nuk mban rimorse në atë histori, kurse zoti Majko mund të ketë gjëra. Nga ato që kam lexuar, kam vërejtje për ato që keni thënë ju atëherë. Kështu që të përpiqemi që ju të korrigjoni çfarë keni thënë nga e shkuara, unë të mos jem gabim dhe kolegët e tjerë të mos jenë gabim.

Zoti Majko, vizioni juaj për sistemin e drejtësisë është ai që dimë se çfarë po ndodh sot. Gjithashtu, është një pikëpyetje e madhe se si me këtë lloj situatë korrupsioni që kemi, jeni gati ta miratoni edhe pa e votuar. Unë them që me mendje të hapur, duke qenë se jemi te fillimi i një faze të re, si në dhjetor të 2015-s, si në mars të 2016-s, jemi te fillimi i një faze të re që do të ecim bashkë deri te fundi, mendjen ta kemi të hapur dhe të gjejmë një zgjidhje që sistemit dhe funksional, të jetë i thjeshtë, mos t'u kushtojë shqiptarëve, mos t'ua bëjë rrëmujë drejtësinë shqiptarëve. Ajo që propozoni ju në mendimin tonë e bën rrëmujë nga koka te këmbët.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj –Mendoj se jemi në fundin e një faze finale që do të na çojë pastaj drejt parlamentit. Mbetet vetëm aneksi që duhet të jetë aneksi kushtetues që do t'i bashkëngjitet projektit kushtetues dhe që pa dyshim është ajo për të cilën jemi dakordësuar të gjithë, procesi i vlerësimit dhe i vetingut në nenet përkatëse të aneksit.

Meqenëse kolegët e opozitës thanë që nesër nuk janë disponibël, pra ditën e shtunë jemi të detyruar të mos e bëjmë se ne nuk do ta bëjmë vetëm mbledhjen. Nuk dëshirojmë ta bëjmë vetëm. Nëse ju do të vazhdoni ta bojkotoni, ne do ta bëjmë vetë mbledhjen. Kjo është e sigurt. Unë po them që nesër të mos e vazhdojmë mbledhjen, ta vazhdojmë ditën e hënë. Dhe meqenëse të hënë jemi të detyruar të bëjmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve, për shkak të seancës së ardhshme paradite, mbledhja e Komisionit të Posaçëm do të jetë ditën e hënë në orën 15:00 pasdite për të mbyllur aneksin e vlerësimit si rend dite. Ditën e mirë!

Fundjavë të mbarë!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë